1969/16 274119

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 326/23
Datë/Datum: 29.03.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:272549

Datë: 23.03.2023

Numri i dokumentit: 04112770

A.nr.1969/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Vjollca Limani, në konfliktin administrativ të paditëses Komuna e Prishtinës, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, përshkak të anulimit të vendimit, pas mbajtjes së seances përgaditore, me dt. 10.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar padia e paditëses Komuna e Prishtinës, e ushtruar kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, me nën shenjën A. nr.1969/16, e dt.20.08.2019.

A r s y e t i m

Paditësja, Komuna e Prishtinës, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me dt.20.08.2019, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, duke kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.274/19, tw datws 03.07.2019, me të cilin është anuluar njoftimi pwr anulimin e aktivitetit tw prokurimit me titull "Furnizimi i shportave tw xhepit dhe ulwsve dhe lënda është kthyer në rishqyrtim të organi i shkallës së parë- Komuna e Prishtinës

Gjykata për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së padisë në gjykatë, i'u referua Ligjit për Konfliktet Administrative, përkatësisht nenit 9, i cili përcakton se "*Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e adminstratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në cështjet administrative*". Ndërkaq neni 10.1 i të njëjtit ligj përcakton se "*të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik dhe juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor*". Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 15.1.2 të të njëjtit ligj, i cili rregullon rastet kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, ku përcaktohet se"15.1.2 *kundër aktëve të nxjerra në cështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ*".

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, bazuar në dispozitën e nenit 9 të LKA, vendimi i të paditurës i kontestuar me padi, PSH.nr.274/19, nga paditësja, me të cilin lënda është kthyer në rishqyrtim te paditësja, nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, mbi këtë arsye gjykata vlerëson se në raport me këtë lloj të vendimit, nuk mund të hapet konflikti administrativ me padi. Por që pala paditëse në këtë rast, është e detyruar që prapë të vendos cështjen sipas udhëzimëve të dhëna nga e paditura në arsyetimin e vendimit të kontestuar.

Në këtë rast organi administrativ në shkallë të parë, Komuna e Prishtinës, është e obliguar të veprojë në afatin e përcaktuar sipas vërjetjeve të vendimit të organit të shkallës së dytë dhe në afatin e përcaktuar të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, duke informuar palët me vendimin e lëshuar.

2019:272550